



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

Kodi: 017

KEC

QEVERISJA DHE UDHËHEQJA NË ARSIM

Objektivat e programit:

Me përvetësimin e këtij programi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të shpjegojnë nocionet themelore të qeverisjes, udhëheqjes, menaxhimit, planifikimit; vlerësimit, kurrikulit etj.
- Të shpjegojnë, argumentojnë dhe të demonstrojnë modele të suksesshme të udhëheqjes, planifikimit; zbatimit të ligjshmërisë në arsim; vlerësimit, zhvillimit të kurrikulit dhe të transformimit të shkollave tradicionale në shkolla efektive.
- Të formulojnë vizionin zhvillimor, misionin, qëllimet, objektivat e përgjithshme dhe të veçanta në procesin e udhëheqjes dhe të qeverisjes.
- Të demonstrojnë aftësi për punë me prioritete.
- Të demonstrojnë aftësi për zbatimin e ndryshimeve në arsim;
- Të demonstrojnë qëndrime pozitive në zbatimin korrekt të ligjeve dhe të dispozitave ligjore në arsimin e Kosovës.
- Të demonstrojnë njohje të thelluar të ligjeve dhe të dispozitave ligjore që lidhen me arsimin.
- Të përpilojnë planin zhvillimor të shkollës në bashkëpunim me ekipin e formuar.
- Të përpilojnë projekte të bazuara në Metodën e Kornizës Logjike.
- Të përpilojnë bateri instrumentesh për monitorim, matje dhe vlerësim në arsim.
- Të hartojnë kurrikula për lëndët e caktuara mësimore dhe për lëndët opcionale.
- Të demonstrojnë aftësi për zhvillimin e trajnimeve në temën: Udhëheqja dhe qeverisja në arsim

Përmbajtja:

1. Bazat e udhëheqjes dhe të qeverisjes.– Shpjegimet themelore terminologjike. Ç'është administrimi - menaxhimi? Ç'kuptojmë me nocionin organizim? Ç'është qeverisja? Ç'është udhëheqja? Bazat e udhëheqjes dhe të qeverisjes. Çfarë duhet të jetë një udhëheqës? Udhëheqja si ndikim. Prioritetet janë çelës i udhëheqjes së suksesshme. Udhëheqja dhe ndershmëria. Udhëheqja dhe ndryshimet pozitive. Aftësia për zgjidhjen e problemeve rrit efektin e udhëheqjes. Qëndrimi zhvillon potencialin e udhëheqësit. Udhëheqja dhe zhvillimi i njerëzve. Vizioni – kusht për udhëheqje të suksesshme. Udhëheqja dhe vetdisiplina. Udhëheqja dhe zhvillimi profesional i personelit. Udhëheqja dhe të nxënët gjatë gjithë jetës. Udhëheqja dhe zbatimi i ligjeve demokratike. Stilet e udhëheqjes. Udhëheqja dhe fazat e zhvillimit të institucionit. Udhëheqja dhe krijimi i INDOK – sistemit. Personaliteti i udhëheqësit.

2. Legjislacioni shkollor.– Koncepti i legjislacionit. Korniza Kushtetuese dhe përgjegjësitë në sferën e arsimit në Kosovë. Metodologjia e miratimit të ligjeve në arsim. Rregullimi me ligj i çështjeve të arsimit me rëndësi për efikasitetin e arsimit. Qëllimet e arsimit. Ligji dhe funksioni gjithëpërfshirës dhe jodiskriminues i arsimit. Përzgjedhja dhe detyrat e drejtorëve- qeverisja në shkollë. Ligji dhe rrjeti i shkollave. Kompetenca dhe përgjegjësitë e organeve të arsimit në dispozitat ligjore. Inspektori shkollor. Ligji, përzgjedhja dhe detyrat e personelit mësimor. Interesi i shoqërisë për shkollim dhe mënyra e financimit të arsimit. Arsimi profesional në dritën e dispozitave ligjore. Programi arsimor. Ligji, vlerësimi dhe vlerësimi me notë i përparimit të nxënësve.

3. Metodatat bashkëkohore të planifikimit.– Ç'është planifikimi. Qëllimi i planifikimit. Llojet e planeve. Plani i zhvillimit të shkollës. Llojet e planeve zhvillimore. Fazat e inkorporimit dhe të njohjes me procesin e planifikimit. Etapat e planifikimit. Vlerësimi i realizimit të Planit të Zhvillimit të Shkollës.

4. Planifikimi i projekteve shkollore.– Ç'është projekti? Përgjegjësia. Përdorimi i Metodës së Kornizës Logjike. Takimi i punës për planifikimin e projektit me Metodën e Kornizës Logjike. Diagnoza e problemeve. Trungjet e problemeve dhe të objektivave. Matrica e kornizës logjike. Plani i realizimit të projektit.

5. Vlerësimi.– Konceptualizimi i vlerësimit. Funksionet e vlerësimit. Objektet e vlerësimit në shkollë. Llojet e vlerësimit. Tipat e vlerësuesve. Procesi i vlerësimit. Procesi i institucionalizimit të vlerësimit. Vlerësimi i nxënësit. Teknikat dhe instrumentet e matjes. Testet. Procedura e testimit. Procedura e vlerësimit. Nota. Vlerësimi i mësuesit dhe i mësimdhënies. Vetëvlerësimi i mësimdhënies. Tabela e specifikimeve Elementet kryesore të vlerësimit të hartimeve. Kriteret për provim me gojë. Përgatitja e nxënësit për vlerësim.

6. Karakteristikat e shkollës cilësore – efektive.– Shkolla si faktor kryesor për zgjidhjen e problemeve postmoderne. Studimet kryesore për efikasitetin shkollor. Ç'kuptojmë me efikasitetin shkollor? Matja e efikasitetit. Konteksti dhe transferimi. Karakteristikat e shkollave cilësore. Qeverisja profesionale. Shkolla efikase ka vizione

dhe qëllime të përbashkëta. Mjedisi i të nxënësve. Përqendrimi në mësimdhënie dhe në të nxënësve. Pritshmëritë e larta. Ndjekja dhe vlerësimi i përparimit. Të drejtat dhe detyrimet e nxënësve. Mësimdhënia përmbajtësore. Shkolla organizatë e të nxënësve. Partneriteti shkollë – familje.

7. Zhvillimi i kurrikulit.– Reflektime dhe mendime të ndryshme për kurrikulin. Planprogrami mësimor dhe kurrikuli. Qasje të ndryshme metodologjike për përcaktimin e lëndëve mësimore. Planprogrami mësimor si fytyra e Janusit. Lavjerrësi i planprogramit mësimor. Koncepti i kurrikulit. Aspekte metodologjike të inicimit, të hartimit dhe të zbatimit të ndryshimeve kurrikulare. Përbërësit e kurrikulit. Vizioni. Qëllimet. Objektivat. Përmbajtjet e kurrikulit. Standardet e përmbajtjeve. Standardet e arritjes. Metodologjitë dhe strategjitë e mësimdhënies. Metodologjitë e vëzhgimit, e monitorimit, të vlerësimit dhe të zbatimit të kurrikulit. Matja e inteligjencës. Kurrikuli dhe tekstet shkollë.

8. Shkolla dhe komuniteti.– Shkolla dhe komuniteti dy sisteme të ndërlidhura. Partneriteti shkollë-komunitet në dritën e Teorisë së Përgjithshme të Sistemeve. Studimet për bashkëpunimin shkollë – komunitet. Nevoja për partneritet dhe partnerët e mundshëm. Planifikimi i partneritetit.

9. Menaxhimi i ndryshimeve.– Ç'është ndryshimi? Ç'mund të jetë objekt ndryshimi në shkollë? Cilët janë agentët e ndryshimit? Cilat janë karakteristikat e njerëzve që sjellin ndryshimin në shkollë dhe në klasë? Si mund të realizohet ndryshimi? Metodot për sjelljen e ndryshimit? Rregullta për të mbështetur ndryshimin. Pengesat për ndryshimin. Gabimet në procesin e ndryshimit

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Programi i organizohet si në formën 22 punëtorive tërëditore të trajnimit dhe 3 takimeve gjysmëditore gjatë të cilave prezantohen rezultatet e zbatimit të njohurive në vendin e punës. Programi ka gjithsej **132 orë**.

Certifikimi

Certifikimi bëhet në dy nivele.

1. Certifikimi për pjesëmarrje
2. Certifikimi për trajnerë.

Kusht për certifikim për pjesëmarrje është përcjellja me rregull e seminareve (mbi 80%) dhe pjesëmarrja në të paktën dy takime gjysmëditore..

Certifikimi për trajnerë bëhet në bazë të punimeve të pavarura të kryera nga pjesëmarrësit dhe të rezultateve të arritura në testim. Testi përbëhet nga një bateri instrumentesh të përgatitura nga doracaku "Qeverisja dhe udhëheqja në arsim".